



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
FAKULTETI I BIOTEKNOLOGJISË DHE USHQIMIT**

Nr. 56 Prot.

Tiranë më, 16/02 2026

Lënda: Kriteret për aplikimin dhe përzgjedhjen e studentëve në ciklin e parë dhe të dytë për vitin akademik 2026-2027 në Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit

REKTORIT TË UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS

A. Kriteret e pranimit në Ciklin e Parë të Studimit, Bachelor

a. Pranimi në programet e studimit të Ciklit të Parë të Studimeve, Bachelor është i mundur për çdo kandidat i cili ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm si dhe që plotëson:

- **Kriterin e meritës.** Nota mesatare e shkollës së mesme e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
- **Kriterin e rëndësisë** (koeficienti i përcaktuar për shkollën nga vjen, sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit).
- **Notën e lëndëve me zgjedhje**
- **Kuotat e paracaktuara** nga Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit

b. Përzgjedhja e kandidatëve fitues në Ciklin e Parë të Studimeve bëhet duke u bazuar në formulën si më poshtë

$$A * K * 0.9 + B * 0.1$$

Ku: A = Nota mesatare e shkollës së mesme
K = koeficienti i përcaktuar për shkollën nga vjen, sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit
B = nota e lëndës me zgjedhje

duke gjeneruar kështoj një listë vlerësimi e cila shpall si fitues të renditurit sipas kësaj liste brenda kuotave të paracaktuara nga Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit për cdo program studimi.

B. Kriteret e pranimit në Ciklin e Dytë të Studimeve, Master i Shkencave

a. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në programin e studimeve për të fituar Diplomën "Master i Shkencave" studentët të cilët kanë përfunduar një program studimi dhe kanë fituar diplomë universitare "Bachelor", "Master Profesional" në sistemin me kohë të plotë dhe të pjesëshme si dhe plotësojnë kriteret akademike si më poshtë:

- **kriterin e meritës.** Nota mesatare e ponderuar e studimeve të Ciklit të Parë (Bachelor), të jetë 6.5 e lart. Në rast se ka ende kuota të lira, nuk do përjashtohen aplikantët me mesatare më të ulët, por në asnjë rast më të ulët se 6.
- **kriterin e rëndësisë** (koeficienti i profilit të studimeve bachelor për sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit).
- **kuotat e përcaktuara nga Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit.**

b. Përzgjedhja e kandidatëve fitues në Ciklin e Dytë të Studimeve, Master i Shkencave do të bëhet duke u bazuar në formulën si më poshtë:

$$A * K$$

Ku: A = Nota mesatare e e ciklit të parë të studimeve Bachelor
K = Koeficient sipas profilit dhe programit të studimit që aplikohet

duke gjeneruar kështoj një listë vlerësimi e cila shpall si fitues të renditurit sipas kësaj liste brenda kuotave të paracaktuara nga Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit për cdo program studimi.

Koeficientët e profilit të studimeve bachelor për sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit për cdo program studimi janë si më poshtë:

- Kandidatët e diplomuar në Teknologji Ushqimore, Teknologji e Pijeve Alkoolike dhe Joalkoolike, Ushqimi dhe Shkencat e të Ushqyerit, Bioteknologji Ushqimore, Kimi Ushqimore do të kenë koeficient 1.00
- Kandidatët e diplomuar jashtë profileve të studimit që është bërë aplikimi koeficienti 0.90

C. Kriteret e pranimit në Master Profesional

a. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në programin e studimeve për të fituar Diplomën "**Master Profesional**" studentët që kanë përfunduar një program studimi dhe kanë fituar diplomë universitare "**Bachelor**", në sistemin me kohë të plotë dhe të pjesëshme si dhe të plotësojnë kriteret akademike si më poshtë:

- **kriterin e meritës** (nota mesatare e ponderuar e studimeve të Ciklit të Parë të Studimeve, Bachelor).
- **kriterin e rëndësisë** (koeficienti i profilin të studimeve bachelor për sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit).
- **kuotat e paracaktuara nga Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit.**

b. Përzgjedhja e kandidatëve fitues në ciklin e dytë të studimeve Master Profesional do të bëhet duke u bazuar në formulën si më poshtë:

$$A * K$$

Ku: A = Nota mesatare e Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor
K = Koeficient sipas profilin dhe programit të studimit që aplikohet

- Kandidatët e diplomuar në Teknologji Ushqimore, Teknologji e Pijeve Alkoolike dhe Joalkoolike, Ushqimi dhe Shkencat e të Ushqyerit, Bioteknologji Ushqimore, Kimi Ushqimore do të kenë koeficient **1.00**
- Kandidatët e diplomuar **jashtë profileve të studimit** që është bërë aplikimi koeficienti **0.85**

